



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHIJAK  
KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 2684 Prot

Shijak, më 18.05.2026.

**Lënda: Kthim përgjigje kërkesës për informacion**

Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, paraqitur në mbështetje të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, lidhur me performancën e shërbimit zjarrfikës në Bashkinë Shijak për periudhën 2023–2024, ju informojmë si më poshtë:

1. Në lidhje me pikën 1 (një) të kërkesës suaj, ku kërkohet informacion mbi numrin aktual të punonjësve të shërbimit zjarrfikës në Bashkinë Shijak, ju bëjmë me dije se aktualisht shërbimi zjarrfikës përbëhet nga 17 persona, nga të cilët 16 efektivë të nivelit bazë dhe 1 Shef Sektori.
2. Në lidhje me pikën 2 (dy) të kërkesës suaj, ku kërkohet informacion mbi numrin total të ndërhyrjeve të realizuara gjatë viteve 2023 dhe 2024, ju informojmë se:
  - gjatë vitit 2023 janë regjistruar 210 raste zjarri dhe rreth 90 ndërhyrje të tjera për shpëtim dhe asistencë, si hapje dyersh, pastrim rrugësh, prerje pemësh etj.;
  - gjatë vitit 2024 janë regjistruar 222 raste zjarri dhe 82 ndërhyrje të tjera.
3. Në lidhje me pikën 3 (tre) të kërkesës suaj, ku kërkohet informacion mbi kohën mesatare të reagimit ndaj emergjencave, ju bëjmë me dije se dalja e mjeteve nga stacioni realizohet mesatarisht brenda 60 sekondave, ndërsa koha e mbërritjes në vendngjarje varet nga distanca dhe vendndodhja e ngjarjes. Në zonat urbane të Bashkisë Shijak, koha mesatare e mbërritjes është rreth 7 minuta.
4. Në lidhje me pikën 4 (katër) të kërkesës suaj, ku kërkohet informacion mbi numrin e automjeteve zjarrfikëse dhe statusin e tyre, ju informojmë se stacioni zjarrfikës disponon aktualisht 4 (katër) automjete, nga të cilat 3 (tre) janë automjete zjarrfikëse operative dhe

- 1 (një) është autobot zjarrfikës, i cili përdoret kryesisht për furnizim me ujë në rastet e zjarreve të përmasave të mëdha.
5. Në lidhje me pikën 5 (pesë) të kërkesës suaj, ku kërkohet informacion mbi mjetet që kanë qenë realisht në përdorim gjatë ndërhyrjeve, ju bëjmë me dije se gjatë ndërhyrjeve janë përdorur 2 automjete zjarrfikëse dhe 1 autobot zjarrfikës.
  6. Në lidhje me pikën 6 (gjashtë) të kërkesës suaj, ku kërkohet informacion mbi trajnimet e zhvilluara për stafin gjatë viteve 2023–2024, ju informojmë se trajnimet zhvillohen në kuadër të gradimeve të efektivëve, si dhe nëpërmjet stërvitjeve periodike që organizohen në vijimësi në stacionin zjarrfikës.
  7. Në lidhje me pikën 7 (shtatë) të kërkesës suaj, ku kërkohet informacion mbi buxhetin e dedikuar për shërbimin zjarrfikës, ju informojmë se:
    - buxheti për vitin 2023 ka qenë 20,342,000 lekë;
    - buxheti për vitin 2024 ka qenë 26,710,000 lekë.
  8. Në lidhje me pikën 8 (tetë) të kërkesës suaj, ku kërkohet informacion mbi planet konkrete për rritjen e kapaciteteve të këtij shërbimi, ju bëjmë me dije se shërbimi zjarrfikës bashkëpunon ngushtësisht me sektorët e tjerë të Bashkisë Shijak, konkretisht me Sektorin e Emergjencave Civile, Sektorin e Pyjeve, përfaqësuesit e fshatrave (kryepleqtë), Njësitë Administrative etj.
  9. Në lidhje me pikën 9 (nëntë) të kërkesës suaj, ku kërkohet informacion mbi zonat që mbulohen nga shërbimi zjarrfikës dhe zonat me vështirësi në mbulim, ju informojmë se vështirësi në aksesimin me mjete zjarrfikëse paraqesin zonat kodrinore, në veçanti fshati Shetel dhe një pjesë e fshatit Kënetë.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

*Shkresa përpilohet në 3 (tre) kopje,*

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR**  
**ZV. KRYETARI**  
Shpresa Domi



**KRYETARI**  
Elton Arbana